



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË (AKR) SHPALL:

THIRRJEN PUBLIKE PËR ORGANIZATAT RINORE DHE/OSE ORGANIZATAT PËR TË RINJTË PËR DORËZIMIN E PROJEKT PROPOZIMEVE

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) krijuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.75/ 2019 “Për rininë”, VKM nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë” duke u bazuar në VKM nr. 566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, financon projektet e propozuara nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë që i referohen prioritetëve rinore të cilave i përmbahet kjo thirrje.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022–2029 si dokumentin bazë për përgatitjen e politikave për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve në Shqipëri dhe adresimin e problemeve me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si përfshirja në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me aktivitete rekreative, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizmi etj.

Organizatrat rinore dhe organizatat për të rinjtë janë aktorë thelbësorë që veprojnë në territor dhe që shërbejnë për të mbështetur mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të të rinjve, shpesh herë përtej veprimtarisë së institucioneve shtetërore. Ligji për Rininë nën nenin 11 të tij, përkufizon organizatat rinore si “persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për OJF-të, objekt aktiviteti i të cilave është përfaqësimi, mbrojtja dhe zhvillimi i interesave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse”. Ndërsa nën nenin 12 të tij, përkufizohen organizatat për të rinjtë si “persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për OJF-të, të cilat në fushën e tyre të veprimtarisë synojnë gjithashtu mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve dhe që kanë përvojë në zbatimin e programeve me ndikim tek të rinjtë.”

Vendimi Nr. 566, datë 20.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes të organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, parashikon që thirrjet konkurruese për projektpropozime nga organizatat rinore dhe për të rinjtë bazohen mbi analizën

e mundësive dhe problematikave për rininë, që adresojnë nevojat dhe prioritetet përcaktuar në strategjitë, planet e veprimit, politikat e programet qendrore dhe vendore për Rininë.

Për sa më sipër, AKR fton të gjitha organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë në Shqipëri që të paraqesin projekt-propozime që janë në përputhje me analizën e mundësive dhe problematikave për rininë dhe objektivat dhe fushat e përparësisë për rininë si më poshtë:

Përcaktimi i qëllimeve politike të strategjisë u mbështet në një proces të gjerë konsultimi mbi prioritetet dhe nevojat e të rinjve përgjatë periudhës tetor 2021-gusht 2022, që përfshiu dëgjesa me mbi 1400 të rinj nga gjimnaze dhe universitete të vendit, 45 organizata rinore dhe për të rinjtë, përfaqësues të 61 njësive të vetëqeverisjes vendore, përfaqësues të organizatave të partnerëve për zhvillim që veprojnë në Shqipëri dhe kanë fokus mbështetjen e të rinjve, Këshillin Kombëtar të Rinisë dhe ministritë e linjës.

Në vijim të një procesi konsultues dhe gjithpërfshirës për përcaktimin e prioritetëve për financim nëpërmjet fondit grant, thirrja e dytë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, synon të adresojë prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 sipas fushave të përparësisë si vijon:

Fusha e përparësisë nr 1: Nxitja e novacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të tek të rinjtë.

Kjo fushë përparësie përfshin nxitjen dhe mbështetjen e novacionit rinor dhe rritjen e aftësive digjitale të shekullit të 21-të për të rinjtë, me qëllim krijimin e mundësive për punësimin cilësor të tyre, zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë të rinjtë dhe zhvillimin ekonomik të komuniteteve ku ata bëjnë pjesë.

Veprimtaritë/idetë e sugjeruara për realizimin e kësaj fushe përparësie përfshijnë (por pa u kufizuar në to):

Zhvillimin e aktiviteteve të trajnimit dhe mentorimit për përvetësimin e aftësive digjitale në fusha që ofrojnë shkallë të lartë punësueshmërie për të rinjtë bazuar në studimet e tregut të punës, si psh. programimi kompjuterik, kodimi, etj.

Promovimin e përdorimit të internetit të sigurt dhe teknologjive të reja nga të rinjtë.

Nxitjen e konkurseve, forumeve dhe formave të tjera të krijimtarisë dhe të shprehurit së të rinjve përmes përdorimit teknologjive moderne dhe digjitale.

Përdorimin e novacionit dhe zgjidhjeve teknologjike nga të rinjtë për të adresuar problematikat me të cilat ata përballen, për të zhvilluar ekonominë vendore, nxitjen e sipërmarrjes rinore dhe vetëpunësimin

Fusha e përparësisë nr 2: Mbështetja e këshillimit në karrierë dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës.

Kjo fushë përparësie synon nxitjen e aftësimin dhe mirëinformimit të të rinjve për të përfituar nga mundësitë për punësim dhe orientim në karrierë dhe për të bërë zgjedhjet autonome, duke arritur potencialin e plotë të tyre kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive.

Veprimtaritë/idetë e sugjeruara për realizimin e kësaj fushe përparësie përfshijnë (por pa u kufizuar në to):



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbështetjen e përvetësimit të aftësive teknike nga të rinjtë që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe ndikojnë avancimin e tyre në karrierë si aftësitë kompjuterike, përgatitja e jetëshkrimit dhe letrës së motivimit, përgatitja e aplikimit të punës etj.

Mbështetjen e përvetësimit të aftësive të buta nga të rinjtë që lehtësojnë përvojën e punës dhe avancimin e tyre në karrierë si aftësitë e komunikimit, negocimit, lidërshiptit, zgjidhjes së konflikteve etj.

Ofrimin e shërbimit të këshillimit për punësim dhe orientim në karrierë, në mënyrë të personalizuar dhe formë miqësore për të rinjtë, përmes përdorimit të metodave moderne dhe të testuara.

Zhvillimin e aktiviteteve të trajnimit dhe mentorimit për avancimin në karrierë dhe tregun e punës së të rinjve në fusha si krijimi i një sipërmarrje, aksesit në grante dhe financime, menaxhimi i fondeve, nxitja e veprimtarisë zejtare etj.

Fusha e përparësisë nr 3: Mbështetja e mirëqënies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve.

Kjo fushë përparësie synon nxitjen mirëqënies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore të të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre.

Veprimtaritë/idetë e sugjeruara për realizimin e kësaj fushe përparësie përfshijnë (por pa u kufizuar në to):

Nxitja dhe promovimi i jetesës së shëndetshme dhe mirëqënies mendore, sociale, fizike dhe seksuale tek të rinjtë përmes ndërjegjësisimit, këshillimit dhe aktivizimit vullnetar në çështje që përshijnë mirëushqyerjen, nxitjen e veprimtarive fizike, parandalimin dhe rehabilitimin ndaj të gjitha formave të dhunës, trajnimit e varësive ndaj pirjes së duanit, drogës, alkoolit dhe lojrave digjitale, shëndetin mendor, shëndetin seksual dhe riprodhues, planifikimin familjar etj.;

Promovimin e shërbimeve shëndetësore miqësore për të rinjtë dhe nxitjen e aksesit të të rinjve në to;

Nxitjen e angazhimit dhe krijimtarisë së të rinjve për promovimin e vlerave kombëtare dhe evropiane përmes zhvillimit të të gjitha llojeve të veprimtarive artistike, kulturore, sociale dhe edukative;

Nxitja dhe promovimi i jetesës së shëndetshme të të rinjve përmes zhvillimit të aktiviteteve sportive (me përjashtim të aktiviteteve të basketbollit dhe volleybollit);

Aspektet ndërdimensionale:

Tërësia e veprimtarive/përjasjes së mësipërme duhet reflektuar në projektpropozime që adresojnë në mënyrë të përshtatshme aspekte si:

Shpërndarje gjeografike në më shumë se një bashki (*për projektpropozimet e organizatave për të rinjtë);

Përfshirje e zonave rurale në ndërhyrje;

Përshirje apo adresim i nevojave së të rinjve në kushte rreziku apo vulnerabiliteti;

Përshirje apo adresim i nevojave i të rinjve me aftësi të kufizuara;

Përshirje e të rejave në ndërhyrje;

Shuma e fondeve për projektet nga organizatat rinore, të miratuara do të jetë deri në 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë.

Shuma e fondeve për projektet nga organizatat për të rinjtë, të miratuara do të jetë deri në 3.500.000 (tre milion e pesëqind mijë) Lekë.

Agjencia Kombëtare e Rinisë rezervon të drejtën të mos i alokojë të gjitha fondet që ka në dispozicion në rast se projekt-propozimet e paraqitura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara. Kohëzgjatja e secilit projekt duhet të zgjasë nga 6 deri në 12 muaj.

PËRSHTATSHMËRIA/PRANUESHMËRIA:

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur, në baza të barabarta, për të gjitha organizatë rinore apo organizatë për të rinjtë, të regjistruara zyrtarisht në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri. **Të gjithë organizatat për të rinjtë dhe rinore të interesuara mund të gjejnë informacion të hollësishëm rreth kushteve për aplikim si dhe për kriteret për financimin e projekteve në Udhëzimin për Aplikantë (Shtojca 6), pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes publike.**

DOKUMENTACIONI:

Të gjitha informacionet e nevojshme, si dhe një version elektronik i paketës së aplikimit mund të gjendet edhe në ëbsite zyrtar të AKR (<http://rinia.gov.al/>).

Sesionet informuese (ditët e hapura për më shumë informacion):

Lidhur me këtë thirrje, për OJF-të e interesuara për të aplikuar në këtë thirrje, sesioni informues i parë, do të mbahet në datën 08.09.2022, ora 10:30 – 12:00, online. Në vijim do të caktohet data për sesionin e radhës (nëse është e nevojshme).

Pyetje rreth kësaj thirrje mund të behën përmes adresëinfo@rinia.gov.al, duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dërgohen deri më **13.09.2022**, ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data e pranimit të pyetjeve përkatëse.

DORËZIMI I APLIKIMEVE:

Aplikimet e plotësuara (me të gjithë dokumentet mbështetëse) duhet të dorëzohen **në 3 (tre) kopje fizike dhe 1 (një) kopje elektronike (USB)**, të vendosura në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar referenca e thirrjes publike, përmes postës zyrtare apo personalisht, gjatë ditëve të punës (e hënë – e premte), gjatë orarit zyrtar, në adresën në vijim:

Agjencia Kombëtare e Rinisë,
Rruga “Naim Frashëri”, Nr. 37
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Afati për dorëzimin e aplikimeve është data **20.09.2022, ora 16:30**. Aplikimet e dorëzuara pas këtij afati do të merren parasysh vetëm nëse vula postare tregon se data dhe koha e dërgimit ka qenë para mbylljes së afatit zyrtar. Pjesa e jashtme e zarfit duhet të përmbajë **titullin e thirrjes për dorëzimin e propozimeve, emrin dhe adresën e plotë të kandidatit, emrin e plotë të projektit** dhe mbishkrimin **“Të mos hapet përpara hapjes zyrtare.”**. Të gjithë aplikantët që kanë paraqitur propozime, pavarësisht nëse pranohen ose jo, njoftohen me shkrim për vendimin e marrë për projekt-propozimin e tyre brenda **45 ditëve** kalendarike nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet do të publikohen në faqen e internetit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë.